

KONTRATE SHIT – BLERJE KUOTE

Sot, me date 28.12.2022 (dymije e njezete e dy), u paraqiten Shitesi dhe Bleresi, te cilet rane dakord per hartimin e kesaj kontrate me termat e meposhtme:

SHITESI:

- Z. Besar Llapashtica, shtetas shqiptar, i lindur ne Fier, me 27.03.1990 dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me numer 038641076 dhe numer personal J00327070S, ortak i shoqerise "Parisol" sh.p.k., zoterues i nje kuote ne masen prej 99% te kapitalit themeltar te shoqerise; *(ne vijim referuar si "Shitesi")*

dhe

BLERESI:

- Z. Miken Dervishi, shtetas shqiptar, i lindur me 16.07.1979, ne Tirane dhe banues ne Tirane, person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit Nr. 035086937 dhe numer personal H90716065P; *(ne vijim referuar si "Bleresi")*

BAZA LIGJORE:

Kodi Civil, Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar

PARAKUSHTE:

- Z. Besar Llapashtica eshte ortak i shoqerise "Parisol" sh.p.k., dhe zoteron ne kete shoqeri nje kuote te saj, e cila perfaqeson 99 % te mases se kapitalit te kesaj shoqerie.
- Shoqeria "Albanian General Electricity" sh.a., eshte ortak i shoqerise "Parisol" sh.p.k., dhe zoteron ne kete shoqeri nje kuote te saj, e cila perfaqeson 1 % te mases se kapitalit te kesaj shoqerie.

Z. Besar Llapashtica, deshiron te shese pjesen prej 99% te kapitalit qe ai zoteron ne shoqerine Parisol sh.p.k dhe bleresi Z. Miken Dervishi, kerkon qe te bleje kete pjese ne masen prej 99% te kapitalit te shoqerise.

Me vendimin e dates 28.12.2022 te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te shoqerise "Parisol" Sh.p.k., u vendos miratimi i shitjes se kuotes ne masen 99% te kapitalit themeltar te shoqerise "Parisol" sh.p.k., qe zoterohet nga z. Besar Llapashtica tek Z. Miken Dervishi.

Bleresi ka kryer due diligence dhe eshte njohur me secilin nga Ortaket e shoqerise "Parisol" sh.p.k., me çdo te dhene dhe tregues te aktivitetit tregtar te shoqerise, te gjendjes ekonomike, financiare dhe juridike te saj, te te drejtave dhe detyrimeve civile, administrative dhe tatimore, aktiveve dhe pasiveve te shoqerise deri ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate.

Bleresi deklaron se eshte ne dijeni te plote te Kontratave dhe Marreveshjeve qe shoqeria "Parisol" Sh.p.k., ka nenshkruar deri ne daten e lidhjes te kesaj kontrate si dhe gjithë detyrimeve dhe te drejtave qe rrjedhin nga keto kontrata, marreveshje apo aktiviteti i shoqerise.

Bleresi deklaron se i pranon dhe nuk ka asnje kundërshtim ne lidhje me sa me sipër, dhe se nuk ka e nuk do te ngreje asnje pretendim ndaj tyre, sot dhe ne te ardhmen per asnje arsye.

Bleresi eshte ne dijeni te Miratimit Paraprak Nr. 324/8 date 23.05.2022 qe shoqeria ka marre nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise dhe te skadimit te tij me date 23.11.2022.

PERMBAJTJA E KONTRATES:

Objekt i kesaj kontrate eshte shitja e kuotes se kapitalit te shoqerise "Parisol" sh.p.k., ne masen prej 99 % te kapitalit themeltar, kuote e cila zoterohet nga ortakut i shoqerise Z. Besar Llapashtca dhe blerja e kuotes perkatesisht nga Z. Miken Dervishi., ne cilesine e bleresit ne kete kontrate.

Shitja e kuotes se mesiperme, e cila perben 99% te kapitalit themeltar te shoqerise "Parisol" sh.p.k., sjell humbjen e se drejtes se pronesise se ortakut z. Besar Llapashtica si pasoje e ketij transaksioni shitjeje, dhe bleresi perfiton te drejten, perkatesisht ne masen 99 % te kapitalit.

KALIMI I PRONESISE MBI KUOTEN:

Pas realizimit te ketij operacioni shit-blerje kuotash sipas kesaj kontrate, struktura e kapitalit te shoqerise tregtare "Parisol" sh.p.k., do te jete si me poshte:

1. Z. Miken Dervishi., zoteron 1 (nje) kuote, ne masen 99 % te kapitalit themeltar te shoqerise "Parisol" sh.p.k.
2. Shoqeria "Albanian General Electricity" sh.a., zoteron 1 (nje) kuote, ne masen 1 % te kapitalit themeltar te Shoqerise "Parisol" sh.p.k.

Titulli i pronesise se 99% te kapitalit te shoqerise "Parisol" sh.p.k nga Shitesi tek Bleresi kalon ne momentin qe kryhet pagesa e plote ne llogarine e shitesit sipas kushteve te percaktuara ne kete kontrate.

ÇMIMI I SHITJES SE KUOTES:

Çmimi i ketij transaksioni shit – blerje kuote te shoqerise te shoqerise "Parisol" sh.p.k., do te jete shuma prej 1.104.405,87 Lek.

Bleresi deklaron se e gjithë vlera do te paguhet me banke brenda 5 diteve nga nenshkrimin i kesaj kontrate ne llogarine bankare te shitesit. Ne rast se Bleresi nuk paguan çmimin e shitjes brenda afatit 5 ditor kontrata quhet e pavlefshme.

DISPOZITA TE FUNDIT:

Ligji i zbatueshem eshte shqiptar. Per çdo gje qe nuk parashikohet ne kete kontrate do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, i ndryshuar.



Bashkelidhur dhe pjese integrale e kesaj Kontrate jane:

- Kopje e leternjoftimeve te paleve nenshkruese;
- Ekstrakt Histori i shoqerise "Parisol" sh.p.k
- Vendimi i Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "Parisol" sh.p.k., te dates 28.12.2022.

Kontrata hartohet ne 4 kopje te njejta ne gjuhen shqipe, nga te cilat nga nje kopje e mbajne palet, nje kopje depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit, nje kopje depozitohet ne aktet e shoqerise.

PALET

SHITESI:

Z. Besar Llapashtica

Besar Llapashtica


BLERESI:

Z. Miken Dervishi

MIKEN DERVISHI


AMENDAMENT NR. 1
I KONTRATES SË SHIT-BLERJE KUOTE DATË 28.12.2022

Sot, më datë 29.12.2022 hartohet dhe nënshkruhet ky Amendament Nr.1 i Kontratës së lidhur midis palëve të poshtëshënuara në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të pavesuar:

Z.Besar Llapashtica, shtetas shqiptar, lindur në Fier, më dt.27.03.1990 dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër 038641076 dhe me numër personal J00327070S, në vijim referuar si “Shitësi”,

Dhe,

Z.Miken Dervishi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më dt.16.07.1979 dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër 035086937 dhe me numër personal H90716065P, në vijim referuar si “Blerësi”,

- *Palët, Z.Besar Llapashtica, në cilësinë e Shitësit dhe Z.Miken Dervishi në cilësinë e Blerësit kanë nënshkruar një kontratë Shit-Blerje Kuote, datë 28.12.2022, me objekt shitjen e kuotës së kapitalit të shoqërisë “Parisol” shpk, në masën prej 99% të kapitalit fillestar, nga Z.Besar Llapashtica në favor të Z.Miken Dervishi;*
- *Sipas kontratës së sipërcituar çmimi i shitjes do të paguhet brenda një afati 5(pesë) ditor, duke nisur ky afat nga data e nënshkrimit të kontratës(dt.28.12.2022);*
- *Meqënëse palët dëshirojnë të shtyjnë afatin e pagesës së çmimit brenda dt.16.01.2023;*

Atëherë hartohet dhe nënshkruhet ky Amendament Nr.1 i Kontratës datë 28.12.2022 me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Ndryshimi i nenit me titull “ÇMIMI I SHITJES SË KUOTËS”

1.1 Neni me titull “Çmimi i shitjes së kuotës” ndryshohet si më poshtë:



“Çmimi i shitjes së kuotës

“Çmimi i këtij transaksioni shit-blerje kuote të shoqërisë “Parisol” shpk, do të jetë në shumën prej 1,104,405.87(një milion e njëqind e katërmijë e katërqind e pesë pikë tetëdhjetë e shtatë) Lekë.

Blerësi deklaron se e gjithë vlera do të paguhet me bankë brenda datës 16.01.2023, në llogarinë bankare të Shitësit, pranë bankës Raiffeisen Bank. Në rast se Blerësi nuk paguan çmimin e shitjes brenda datës 16.01.2023, kontrata quhet e pavlefshme.

Neni 2
Kushtet e tjera

2.1 Të gjitha kushtet e tjera të Kontratës së lidhur midis palëve të sipërpërmendura, mbeten të vlefshme dhe të pandryshuara.



2.2 Palët ruajnë të njëjtat të drejta dhe detyrime të parashikuara në kontratën e lidhur ndërmjet tyre.

2.3 Ky Amendament Kontratë i bashkëlidhet Kontratës fillestare datë 28.12.2022.


Neni 3
Hyrja në Fuqi

3.1 Ky Amendament hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga palët.

Ky Amendament përpilohet në 3(tre) kopje në gjuhën Shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, nga një kopje për secilën palë dhe një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë, dhe nënshkruhet rregullisht nga palët.

PALËT

Shitësi
Z.Besar Llapashtica

Besar Llapashtica


Blerësi
Z.Miken Dervishi

MIKEN DERVISHI
